



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1479/4 Prot

Tiranë, më 16/12/2020

VENDIM

Nr. 52, datë 16.12.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr.1479 Prot., datë 24.11.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet shkresës datë 02.11.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni si:

- 1) *Shkresa nr. 443/1 Prot., datë 01.10.2020 “Opinion ligjor mbi raportin e angazhimit të auditimit nr. 443 Prot., datë 16.01.2020 (dokument i kërkuar edhe nëpërmjet e-mail-it datë 12.10.2020 drejtuar Autoritetit Rrugor Shqiptar (në vijim “ARRSH”).*
- 2) *Çdo “Urdhër për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës dhe Financiare” si dhe propozimet përkatëse lidhur me këto urdhëra, referuar shkresës nr. 443/2 Prot., datë 02.10.2020, Njoftim për “Raportin përfundimtar të Auditimit të Brendshëm” dhe “Përfundimet e angazhimit të Auditimit të Brendshëm të Veprimtarisë së DSHB”, Kapitulli III: “Gjetje dhe Konkluzione” sikurse citohet: “Brenda një dite, ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës me 13 punonjës të ARRSH-së” si edhe “17 raste të larguar në mënyrë të padrejtë të cilët i janë drejtuar Gjykatës për gjykim”. Lidhur me*

- këto 13 raste dhe 17 raste të pasqaruara dhe të pidentifikuara në shkresën e sipërcituar, as në emër/mbiemër punonjësi dhe as në shkresa zyrtare Nr. Prot...*
- 3) *Çdo "Urdhër për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës dhe Financiare" si dhe "Propozimet përkatëse lidhur me këto Urdhëra", të nënshkuara nga kërkuesja gjatë periudhës 17.05.2019 – 16.10.2019.*
 - 4) *Vërtetim ku të saktësohet se: "Gjatë periudhës së punësimit në ARRSH, 17.05.2019 – 02.10.2020, kërkuesja nuk ka marrë asnjë masë disiplinore".*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 8418/1 Prot., datë 19.11.2020, ka vendosur në dispozicion të kërkueses informacionin në lidhje me pikat 1 dhe 4 të kërkesës të sipërcituar. Lidhur me pikat 2 dhe 3 ka sqaruar ndër të tjera se: *"...në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditit të Brendshëm, është komunikuar dhe me Përgjegjësen e Auditit të Brendshëm pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe na është komunikuar që znj. Vilma Vero është njoftuar në lidhje me këtë auditim dhe në takimin pajtues zhvilluar me datë 27.12.2019 nuk u paraqit, vërtetuar sipas procesverbalit mbajtur me këtë datë. Gjithashtu nuk ka paraqitur asnjë observacion apo kundërshtim lidhur me angazhimin e auditimit si dhe gjetjeve të tij. Për sa më sipër, me dokumentat e kërkuara në pikat 2 dhe 3, kërkuesja ka pasur mundësi të njihet kur është njoftuar me raportin e auditit të brendshëm. Për kopje të këtyre dokumentave duhet t'i drejtohet sektorit të Arkiv Protokollit pasi ato janë dokumenta të vitit 2019".*

Ankuesja, pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, pretendoi ndër të tjera se: *"...Argumenti i sipërcituar bie ndesh me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku në asnjë rast nuk përcaktohet refuzimi i së drejtës për informim bazuar në mospjesmarrjen në një takim pajtues aspak të detyrueshëm".*

Në vijim, i është drejtuar Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji nr.119/2014").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, dhe nenin 31/1c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Komisioneri me shkresën nr. 1479/1 prot., datë 26.11.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe rivlerësimin e dhënies së informacionit.

Në vijim, me shkresën nr. 9329/1 prot., datë 07.12.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1479/2 prot., datë 09.12.2020, Autoriteti Publik ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion me pretendimin se: *“...në bazë të Vendimit Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrit qëndror të personelit”, informacioni që kërkohet ka të bëjë me të dhëna personale dhe është i vendosur në dosjen e personelit, rrjedhimisht kërkuesja nuk legjitimohet të pajiset me një informacion të tillë pasi dosja e personelit është konfidenciale.”*

Ankuesja, pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ka vijuar ankimin nr. 1479/3 prot., datë 11.12.2020, pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ndjekjen e mëtejshme të procedurave në përputhje me Ligjin nr. 119/2014.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion, nuk qëndrojnë.

Komisioneri vlerëson se, nisur nga informacioni që kërkohet, kjo çështje duhet të trajtohet me ligjin nr. 119/2014, por edhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Nga shqyrtimi i kërkesës dhe konsultimi i legjislacionit përkatës, rezulton se kemi të bëjmë me informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014, ku *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Në parim aksesimi dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në qëndrimin e fundit të institucionit konstatohet se kufizimi i aksesit është bërë në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrit qëndror të personelit”, pa marrë parasysh dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në shkronjën b) të pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.

Në rastin konkret, duke mos gëzuar më të drejtën për të qenë funksionar publik, lidhur me motivacionin e largimit, bazuar në shkronjën a) të pikës 1 të nenit 17 të Ligjit nr.119/2014, e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik, duhet të vendosë në dispozicion të kërkueses dokumentacionin e kërkuar në pikën 2 dhe 3 të kërkesës për informacion, në formatin e disponuar, duke anonimizuar përshkrimin e plotë të motivacionit të largimit të secilit punonjës, në zbatim të pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr.119/2014, në të cilin parashikohet se: *“...nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuetit...”*. Duke respektuar në këtë mënyrë proporcionalitetin në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë të të dhënave.

E drejta për informimin, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t'i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e Ligjit nr. 119/2014 parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre është në interesin publik.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 1479 Prot., datë 24.11.2020 të znj. _____, ndaj Autoritetit Publik “Autoriteti Rrugor Shqiptar”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 02.11.2020, konkretisht: *(2.Çdo “Urdhër për Ndërrprerjen e Marrëdhënies së Punës dhe Financiare” si dhe propozimet përkatëse lidhur me këto urdhëra, referuar shkresës nr. 443/2 Prot., datë 02.10.2020, Njoftim për “Raportin përfundimtar të Auditimit të Brendshëm” dhe “Përfundimet e*

angazhimit të Auditimit të Brendshëm të Veprimtarisë së DSHB”, Kapitulli III: “Gjetje dhe Konkluzione” sikurse citohet: “Brenda një dite, ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës me 13 punonjës të ARRSH-së” si edhe “17 raste të larguar në mënyrë të padrejtë të cilët i janë drejtuar Gjykatës për gjykim”. Lidhur me këto 13 raste dhe 17 raste të pasqaruara dhe të pidentifikuara në shkresën e sipërcituar, as në emër/mbiemër punonjësi dhe as në shkresa zyrtare Nr. Prot...; 3.Çdo “Urdhër për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës dhe Financiare” si dhe “Propozimet përkatëse lidhur me këto Urdhëra”, të nënshkruara nga kërkuesja gjatë periudhës 17.05.2019 – 16.10.2019), brenda datës 23.12.2020.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 16.12.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

